




|  |                                    |
|--|------------------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO                              |                                    |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT<br>AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE<br>ANTI-CORRUPTION AGENCY |                                    |
| Dep.<br>Dep.<br>Dep.   | Nr. Prot.<br>Br. Prot.<br>Prot No. |
| <u>DPKI</u>  | <u>06-1410/20</u>                  |
| Nr. i faq.<br>Broj stranica<br>Nr. pages   | Data<br>Datum<br>Date              |
| <u>02</u>  | <u>01.07.2020</u>                  |
| PRISHTINË  |                                    |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1, nenit 5 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.5, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 29.06.2020, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-DPKI-06-1110/20, për zyrtarin e lartë publik z. Naser Ramadani, Drejtor Ekzekutiv në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt të mundshëm interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Naser Ramadani, Drejtor Ekzekutiv në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr.06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka identifikuar rastin e konfliktit të mundshëm të interesit, sipas të cilit z. Ramadani duke qenë zyrtarë i lartë publik, njëkohësisht ka mbajtur edhe funksionin e Kryetarit dhe personit të autorizuar në dy Organizata Joqeveritare (tutje: OJQ).

Për t'i vërtetuar dyshimet, Agjencia kundër Korrupsionit ka kërkuar informata dhe dokumentacion nga Departamenti i Organizatave Joqeveritare në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike (tani Ministrisë së Punëve të Brendshme). Nga informatat e pranuar përmes shkresës zyrtare me numër DPKI-06-776/20 është konstatuar se z. Ramadani e mban funksionin e Kryetarit dhe personit të autorizuar në OJQ-të, "Akademia e Shkencave Mjekësore të Kosovës" dhe "Shoqata e Mjekëve të Kosovës".



Lidhur me këtë, Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare nr. AKK-DPKI-06-1275/20 për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.

Pas pranimit të kësaj shkrese nga z. Ramadani, i njëjti ka kontaktuar Agjencinë kundër Korrupsionit, për tu njoftuar për situatën e mundshme të konfliktit të interesit. Me këtë rast Agjencia e ka njoftuar atë se gjatë ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, nuk mundet që njëkohësisht të ushtrroj edhe funksionin e drejtuesit apo përfaqësuesit në organizata joqeveritare, pasi që një gjë e tillë bie ndesh me nenin 13 paragrafi 1 të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, në të cilin thuhet se:

***“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”***,

Kufizimi i tillë është paraparë edhe me nenin 14 paragrafi 1 të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, në të cilin thuhet se:

***“Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të tjera të lidhura me to”***

Zyrtari i lartë z. Ramadani, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe ka premtuar se do të ndërmarrë veprime në mënyrë që ta shmang gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar shkresën zyrtare *DPKI-06-1275-1/20* me dokumentet përcjellëse, në bazë të së cilave dëshmohet se zyrtari i lartë ka dhënë dorëheqje nga funksioni i kryetarit në OJQ-të, “Akademia e Shkencave Mjekësore të Kosovës” dhe “Shoqata e Mjekëve të Kosovës”, dhe njëkohësisht ka bërë ndryshimet e nevojshme pranë Departamentit të OJQ-ve lidhur me personin e autorizuar në të dy OJQ-të e lartë cekura.

Me veprimet e ndërmarra nga z. Ramadani, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI - së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip HAVOLLI  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

